



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-130

Prishtinë, më 21 tetor 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 TETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit për pikat e papërfunduara të seancës plenare, të filluar më 17 tetor 2013, e cila për mungesë të kuorumit i kishte ndërprerë punimet.

Kryetari propozoi që, duke pasur parasysh mungesën e deputetëve në seancën e fundit, si dhe angazhimin e deputetëve në fushatën parazgjedhore, të shihet mundësia që Kuvendi të mos ketë seancë plenare deri në mbajtjen e zgjedhjeve, më 3 nëntor 2013.

Lidhur me propozimin e kryetarit diskutuan: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Rasim Demiri, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, Kryesia nuk vendosi për caktimin ose jo të datës për vazhdimin e seancës plenare deri sa të përfundojë fushata parazgjedhore. Por, për këtë u vendos që kryetari i Kuvendit të konsultohet edhe me kryetarët e grupeve parlamentare në mbledhjen e nesërme, më 22 tetor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale